



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 23.06.2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1262\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 15 , dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);

**në seancën e mbajtur me datë 23.06.2020, nxori këtë:**

## **VENDIM**

### **I. MIRATOHET amandamentimi i dokumentit i Rregulla dhe Metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Termike**

#### **Arsyetim**

- Në ligjin për Energjinë - Nenin 8 thuhet: *“Metodologjia, rregullat dhe procedurat e përgatitjes dhe miratimit të Bilancit Vjetor dhe Bilancit Afatgjatë të Energjisë përcaktohen me rregullore të veçantë që hartohet dhe miratohet nga Rregullatori”.*
- Me fillimin e liberalizimit të tregut kanë ndryshuar rrethanat në furnizimin e konsumatorëve, përfshirë importet dhe eksportet që ndikon në formulat për llogaritje. Po ashtu gjatë implementimit të dokumentit është vërejtur si e nevojshme që pjesa që ka të bëjë më rishikimin e bilancit vjetor të ndryshohet. Për këto arsye ZRRE ka iniciuar ndryshime në dokumentin në fuqi. Pas draftimit të ndryshimeve dokumenti është dërguar për diskutim publik dhe janë pranuar komente në formë të shkruar nga palët e interesit. ZRRE ka analizuar komentet dhe ato të cilat kanë qenë të vlefshme për përmirësimin e përmbajtjes dhe kualitetit të dokumentit janë përfshirë, si dhe janë sqaruar çështjet e ngritura, dhe dokumenti është prezantuar para bordit për aprovim.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit ka vlerësuar se dokumenti është në harmoni me legjislacionin e sektorit të energjisë në Kosovë duke i konsideruar si të vlefshme ndryshimet

**Vendim – Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë elektrike dhe termike 1**

Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org



në dokument, dhe përmes këtij vendimi ka miratuar amendamentimin e dokumentit "Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë elektrike dhe termike"

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.


Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Rregulla dhe Metodologjia për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë elektrike dhe termike**

Vendimi i dërgohet:

Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejriaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar